

**AKT THEMELIMI**  
**I SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR**

**“ MARSHEA II ” SH.P.K.**

Sot, më date **24.10.2023**, une i nënshkruari:

- **Armir Sharka** lindur me 25/05/1997, ne Lushnje dhe me rezidence ne Lushnje, shtetas Shqiptar i identifikuar nepermjet pasaportes me nr.**032961988**, madhor me zotesi te plote juridike per te vepruar....; ne perputhje me Ligjin Nr. 9901, date 14.04.2008, “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare” kam vendosur të themeloje një Shoqëri me Përgjegjësi të Kufizuar të emëruar “ **MARSHEA II** ” **SH.P.K.** (më poshtë referuar si “Shoqëria”), duke nënshkruar këtë Akt Themelimi. Aktiviteti i kësaj Shoqërie do të rregullohet nga Statuti i saj, i cili është pjesë përbërëse e këtij Akti Themelimi dhe i bashkëngjitet si Shtojca 1.

**Neni 1**

Emri i Shoqërisë është: “ **MARSHEA II** ” **SH.P.K.**

**Neni 2**

(1)Selia e shoqërisë ndodhet në adresën: Lushnje, Lagja “Kadri Qystri”, rruga Darsia, godine me nr.pasurie 399/56, zone kadastrale nr.2342 .

(2)Adresa e shoqërisë për qëllime komunikimi elektronik është si vijon: marsheakontabilitet@gmail.com Shoqëria ka te drejte te hape dege apo filiale ne te gjithë territorin e Republikës se Shqipërisë.

**Neni 3**

-Kohëzgjatja e shoqërisë do të jetë 10 vjet dhe fillon qe prej dates se regjistrimit te saj ne Regjistrin e Shoqërive Tregtare ne Qendren Kombetare te Biznesit.

**Neni 4**

**Objekti**

Shoqëria do të kryej aktivitetin e mëposhtëm :

- a. Studio profesionale te lira, avokati, noteri, kontabel i miratuar, inxhinieri, arkitekt, projektues etj. Konsulence juridike- financiare , sherbime te tjera juridike ekonomike , sherbime software fiscal. Agjenci sherbimesh , agjenci turistike dhe turizmi , agjenci menaxhimi , ndermjetsimi dhe bashkpunimi hospitality . Agjensi imobiliare, studime tregu, komisioneri dhe agjensi per te tretet, konsulente per shitje dhe gira te pasurive te luajteshme dhe te paluajteshme, dhe cdo veprimtari tjeter



pa kufizim qe ka lidhje me ndermjetesimin kombetar dhe nderkombetar te pasurive te luajteshme dhe te paluajteshme. Dhenie me qera dhe perdorim te makinetave dhe lojrave te ndryshme per femije, etje .

-Megjithate shoqeria ka te drejte qe te shtoje dhe te ndryshoje objektin e veprimtarise se saj me vendim te asamblese se ortakeve.

## **Neni 5**

### **Kapitali themeltar**

(1)Kapitali themeltar fillestar i shoqërisë është **100 000** (njqind mije) Lekë

Pjesëmarrja e themeluesve në kapitalin e shoqërisë është në përputhje me kontributet e tyre të mëposhtme:

1. Ortaku themelues **Z. Armir Sharka** : Zotërues i 1 (një) kuote me vlerë të përgjithshme prej **100 000** (njqind mije) Leke që përbën **100 %** të kapitalit themeltar të shoqërisë.

Kontributi i ortakëve do të jetë në para.

## **Neni 6:**

### **Zmadhimi dhe zvogëlimi i kapitalit**

Shtimi ose pakesimi i kapitalit themelor mund te behet vetem pasi Asamblea e ortakeve me shumice e ka dekretuar kete dhe per me teper te gjithe ortaket jane te detyruar qe ta repektojne dhe te kontribuojne ne para ose ne natyre ne baze te vendimit te shumices se asamblese

## **Neni 7:**

### **Transferimi i kapitalit**

Kuotat e kapitalit te një shoqërie me përgjegjësi të kufizuar e te drejtat që rrjedhin prej tyre mund te fitohen apo kalohen pëpërmjet:

- a) kontributit në kapitalin e shoqërisë
- b) shitblerjes;(me te drejten e parablerjes nga ana e ortakeve).
- c) trashëgimise;
- d) dhurimit;
- e) cdo menyre tjetër të parashikuar me ligj.

Pjesët e kapitalit themeltar janë ligjerisht të trasferueshme ndërmjet ortakëve,përsa nuk parashikohet ndryshe në statut.

Pjesët e kapitalit themeltare janë ligjerisht të trasferueshme me rrugë trashgimnie.



## **Neni 8**

### **Organi Vendimmarres**

Asambleja e Ortakeve është organi i vetem vendimmarrës i shoqërisë. Asambleja e Ortakeve është organi i vetem vendimmarrës i shoqërisë që miraton çdo ndryshim të statutit sipas modaliteteve të përcaktuara në ligj.

Mënyra e thirrjes së mbledhjes së Asamblesë së Përgjithshme, kuorumi, marrja e vendimeve ,përfundimi nga e drejta e votës dhe të tjera modalitete për funksionimin e organit vendimmarres përcaktohen në statutin e shoqërisë.

## **Neni 9**

### **Administrimi**

Administrator i shoqërisë emërohet z.**Armir Sharka** lindur me 25/05/1997, në Lushnjë dhe banues në Lushnjë, shtetas Shqiptar i identifikuar nepermjet leternjoftimit nr.**032961988**, madhor me zotesi të plote juridike për të vepruar, i zgjedhur për një periudhë **5** vjetecare me të drejta rizgjedhje.

Kompetencat dhe përgjegjësitë e Administratorit janë të përcaktuara qartë në statutin e shoqërisë.

## **Neni 10**

### **Viti financiar-ekspertët**

Viti financiar i shoqërisë fillon me 1 Janar dhe përfundon me 31 Dhjetor. Përfundimisht, viti i parë financiar fillon nga data e regjistrimit në Qendrën Kombëtare të Biznesit dhe mbyllet më 31 Dhjetor.

Eksperti ka për detyrë që të kontrollojë të gjithë dokumentacionin kontabel të veprimtarisë ekonomike tregtare të shoqërisë, atë gjithëvjetor dhe atë në lidhje me kontrollet periodike të ushtruara prej tij për rastet kur ai është ngarkuar dhe ka kryer një gjë të tillë i ngarkuar nga ana e ortakëve.

Në përfundim të kontrollit eksperti kontabel i autorizuar përgatit raportin me shkrim për nxirjen e rezultatit të bilancit financiar vjetor si dhe për atë për kontrollet periodike të ushtruara, të cilat është i detyruar që tja paraqesë e ta dorëzojë në kohë ortakëve për të shqyrtuar e miratuar mbi bazën e të drejtës vendimore që ka.



## **Neni 11**

### **Prishja-riorganizimi i shoqërisë**

Modalitetet për prishjen dhe riorganizimin e shoqërisë janë të përcaktuara në statutin e shoqërisë në përputhje me dispozitat ligjore të parashikuara në Pjesën IX të Ligjit 9901 datë 14.04.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”.

## **Neni 12**

Akti i Themelimit është hartuar në 4 kopje origjinale.

**ORTAKU I VETEM I SHOQËRISE**

**Armir Sharka**

Armir Sharka

